



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2020:170215  
Datë: 24.08.2021  
Numri i dokumentit: 02110855

**ARJ.UZVP.Nr.74/2021**

**Gjykata Supreme e Kosovës**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Nebojsha Boriçiq, kryetar i kolegjit, Erdogan Haxhibeqiri dhe Beshir Islami anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrje të bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çeshtjen administrative sipas padisë së paditësve - Faton Selmanaj, Xhavit Kuqi dhe Muharrem Lulaj, të gjithë nga Deçani, të cilët me autorizim i përfaqëson Getoar Mjeku, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës – Ministrisa e Ekonomisë dhe ambientit, Zyra e Rregullatorit për energji dhe palës së interesuar „KelKos Energi“ sh.p.k, për shkak të anulimit të vendimit të paditurës, duke vendosur sipas kërkesës së paditësve për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësorë, parashtruar ndaj aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZh.nr.320/21 dt. 26.04.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 28.07.2021, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Aprovohet si e bazuar kërkesa e paditësve Faton Selmanaj, Xhavit Kuqi dhe Muharrem Lulaj, për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësorë, parashtruar ndaj aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZh.nr.320/21 dt.26.04.2021.

Priset aktvendimi i Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZh.nr.320/21 dt. 26.04.2021.

Mbetet në fuqi aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çeshtje administrative A-U.nr. 2081/20 dt.11.02.2021.

### Arsyetim

Me aktvendimin e goditur të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZH.nr.320/21 dt. 26.04.2021, janë aprovuar si të bazuara ankesat e të paditurave - Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, Zyra e Rregullatorit për Energji dhe palës së interesuar „KelKos Energi“ sh.p.k, të parashtruara ndaj aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çeshtje Administrative A-U.nr.2081/20 dt. 11.02.2021, me të cilin është aprovuar si i bazuar propozimi i propozuesve – paditësve Faton Selmanaj, Xhavit Kuqi dhe Muharrem Lulaj për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të paditurës. Gjykata e Apelit me aktvendimin e goditur ka ndryshuar aktvendimin e cekur të gjykatës së shkallës së parë dhe ka refuzuar si të pabazuar propozimin e propozuesve – paditësve për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të paditurës.

Paditësit në këtë gjykatë kanë paraqitur kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësorë, me të cilin e kontestojnë ligjshmërinë e aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZh.nr. 320/21 dt. 26.04.2021. Pretendojnë se aktvendimi i kontestuar është marrë me aplikim të gabuar të së drejtës materiale dhe shkeljes së dispozitave të procedurës, me propozimin që kërkesa të aprovohet, të prishet aktvendimi i goditur i Gjykatës së Apelit dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së dytë në rishqyrtim apo që Gjykata Supreme të nxjerrë vendimi meritor.

E paditura, Zyra e Rregullatorit për Energji dhe pala e interesuar „KelKos Energi“ sh.p.k, kanë paraqitur përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësorë të paditësit me propozimin që e njehta të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në pajtim me nenin 53 të Ligjit për konfliktet administrative ka mbajtur seancën dhe pas vlerësimit të aktvendimit të goditur, të pretendimeve të paditësit në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësorë, të përgjigjës të paditurës dhe të palës së interesuar dhe pas rishikimit të shkresave tjera të lëndës:

Kërkesa e palës së interesuar për rishqyrtim të jashtëzakonshëm është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çeshtje Administrative A-U.nr.2081/20 dt.

11.02.2021, është aprovuar si i bazuar propozimi i propozuesve – paditësve Faton Selmanaj, Xhavit Kuqi dhe Muharrem Lulaj për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të paditurave dhe është shtyrë ekzekutimi i vendimeve të kontestuara të paditurave deri në nxjerrjen e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë sipas padisë së paditësit. Në fakt, me aktvendimin e cekur të gjykatës së shkallës së parë në pikën I të dispozitivit është aprovuar si i bazuar propozimi i paditësve – propozuesve Faton Selmanaj, Xhavit Kuqi i Muharrem Lulaj. Në pikën II të dispozitivit është shtyrë ekzekutimi i vendimeve të paditurës së parë - Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit: Vendimi, Leja Ujore (L.U.) për HC Belaja, L.U.13,4981/20 dt. 03.11.2020; Vendimi, LU për HC Deçan, LU 14,4982/20 dt. 04.11.2020; Vendimi për mjedisin (LM) për HC Belaja, 19/5837/ZSP dt. 06.11.2020; Vendimi për LM për HC Deçani, 19/5837/ZSP dt. 06.11.2020, Vendimi LU për HC Lumbardhi (Bistrica) II, LU nr.5058 dt. 03.02.2021, derisa Gjykata të vendos me vendim përfundimtar gjyqësorë përkitazi me padinë e paditësve. Në pikën III është shtyrë ekzekutimi i vendimeve të paditurës së dytë- Rregullatorit të energjisë, siç janë Vendimi V -1303-2020 dt. 12.11.2020, Vendimi V-1304-2020 dt. 12.11.2020; Licenca për prodhimin e energjisë elektrike për HD Deçan, Li-49/20 dt. 12.11.2020 dhe Licensë për prodhimin e energjisë elektrike për HC Belaja, Li -50/20 dt 12.11.2020, deri në marrjen e vendimit përfundimtarë gjyqësorë sipas padisë së paditësit. Gjykata e Apelit me aktvendimin e goditur AA.UZH.nr. 320/21 dt. 26.04.2021, ka aprovuar si të bazuara ankesat e të paditurave - Ministria e Ekonomisë dhe Mjedisit Hapësinor, Zyra e Rregullatorit për energji dhe palës së interesuar „KelKos Energi“ sh.p.k, të ushtruara ndaj aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative A-U.nr. 2081/20 dt. 11.02.2021, ka ndryshuar aktvendimin e cekur të gjykatës së shkallës së parë dhe ka refuzuar si të pabazuar propozimin e propozuesve – paditësve për shtyrje të ekzekutimit të vendimeve të paditurave.

Me nenin 22, paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative është përcaktuar se me kërkesën e paditësit, organi, akti i të cilit ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar. Me nenin 22, paragrafi 6 i ligjit të cekur është përcaktuar se paditësi mund të kërkojë edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2. të këtij neni.

Gjykata e Apelit në arsyetimin e vendimit të saj ka theksuar se „paditësit – propozuesit nuk kanë paraqitur asnjë rrethanë që është parakusht për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të kontestuar, e cila në rast se do të ekzekutohej do t'u shkaktonte paditësve në mënyrë të drejtëpërdrejtë humbje, përveç që kanë

përmendur faktin se me ekzekutimin e këtij vendimi do t'i shkaktohej dëm i pariparueshëm pasi që të njejtëve do cenohej prona ku është ndërtuar termocentrali dhe me këtë do u reduktohej uji që furnizon familjet e tyre. Nuk ka pasur prova konkrete se në çfarë mase të njejtëve do tu reduktohej furnizimi me ujë. Termocentrali për prodhimin e energjisë është ndërtuar për nevojat e furnizimit me energji elektrike për një pjesë të qytetarëve të Deçanit, kështu që shtyrja e ekzekutimit të një vendimi të tillë në rastin konkret do të mund të shkatonte dëm direkt të pariparueshëm për palën e interesit (kompaninë) 'Kelkos energy' sh.p.k. Deçan, pasi që investimi për ndërtimin e termocentralit është i madh, dhe ky dëm në mënyrë indirekte do të shkaktohej dëm të pariparueshëm për atë pjesë të qytetarëve që furnizohen me energji elektrike. Poashtu, paditësit –propozuesit nuk kanë paraqitur asnjë rrethanë të besueshme i cili është parakusht i dytë se shtyrja e ekzekutimit nuk do të ishte në kundërshtim me interesat e publikut dhe se nuk do t'i sillte ndonjë dëm palës kundërshtare, pasi që shtyrja e ekzekutimit të vendimeve të paditurave do të ishte kundër interesit publik, për arsyet e përmendura më lartë, ndërsa kompania Kelkos Energy posedon të gjitha vendimet, lejet, licencat me të cilat ka marrë për obligim që me rastin e prodhimit të energjisë elektrike ti përmbahet kushteve për mbrojtjen e ambientit, ujit dhe kushteve tjera që i ka përcaktuar Ministria“.

Gjykata Supreme nuk mund ta pranoj si të drejtë qëndrimin e tillë të gjykatës së shkallës së dytë. Mungojnë arsyet dhe faktet vendimtare, ndërsa të njejtat as nuk janë arsyetuar në përputhje me provat në shkresat e lëndës, Prandaj, në rastin konkret gjykata e shkallës është dashur të vlerësoj se a janë plotësuar në mënyrë kumulative të gjitha kushtet për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të kontestuar, në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit për Konfliktet Administrative, e që sipas mendimit të kësaj gjykate i njëjti këtë nuk e ka bërë. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, arsyetimi i Gjykatës së Apelit është i mangët sa i përket fakteve vendimtare, siç është mundësia e shkakimit të dëmit të pariparueshëm, përderisa shtyrja nuk do ishte në kundërshtim me interesin publik, dhe nuk do të shkaktohej ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, gjegjësisht palës së interesuar. Prandaj rezulton e qartë se arsyetimi i aktvendimit të goditur të Gjykatës së Apelit nuk ka mbështetje në kuptim të provave në shkresa të lëndës, kështu që të gjitha këto shpien në përfundimin se gjykata e shkallës së dytë me rastin e vlerësimit të propozimit të paditësit -propozuesit nuk i ka vlerësuar në tërësi faktet dhe provat e nxjerra.

Sipas mendimit të kësaj gjykate, paditësit – propozuesit me padi dhe me shkresën e dates 02.02.2021 kanë prezantuar prova bindese me të cilat vërtetohen faktet se me ekzekutimin e vendimit do t'u shkaktohej dëm qytetarëve të cilët janë në pronat e tyre dhe jetojnë në atë mjedis ku është paraparë puna e këtyre hidrocentraleve me ç rast do t'u shkaktohej dëm i pariparueshëm të njejtëve. Kjo gjykatë poashtu ka konstatuar se ekzekutimi i vendimeve deri në marrjen e

vendimit përfundimtar meritor nuk do të ishte në kundërshtim me interesin publik dhe shtyrja nuk do të shkaktonte ndonjë humbje më të madhe palës kundërshtare, gjegjësisht palës së interesuar. Në këtë mënyrë njëkohësisht në të ardhme do të shmangen pasojat e mundshme në rast se në fund të procesit gjyqësorë do të vërtetohej se vendimet e kontestuara të paditurave kanë qenë në kundërshtim me ligjin.

Duke pasur parasysh këto që u thanë lartë, kjo gjykatë ka vendosur të prish aktvendimin e goditur të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZh.nr. 320/21 dt. 26.04.2021 dhe të lë në fuqi aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çeshtje Administrative A -U. nr.2081/20 dt.11.02.202, me të cilin është aprovuar si i bazuar propozimi i propozuesve – paditësve Faton Selmanaj, Xhavit Kuqi dhe Muharrem Lulaj për shtyrje të vendimit të paditurës derë në nxjerrjen e aktgjykimit të shkallës së parë sipas padisë së paditësve.

Nga të gjitha që u thanë dhe në pajtim me nenin 54, paragrafi 1 dhe 2 lidhur me nenin 22, paragrafi 2 dhe 6 të Ligjit për konfliktet administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Data 28.07.2021, ARJ - UZVP.nr.74/2021**

**Procesmbajtës,  
Bujar Balaj**

**Kryetar i kolegjit,  
Nebojsa Boriçiq**

**Përktheu: Drita Kelmendi**

